



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2021:136834
Datë: 30.12.2024
Numri i dokumentit: 06664687

Kom.Dh.Shk.II.nr.302/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “NTG Blendi” me nr. Biznesi 80077076 me seli ne Prishtinë rr.”Gustav Mayer” nr.13, te cilin e përfaqëson sipas autorizimit Armend Deskaj avokat ne Prishtinë, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura “Istrefi” me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur sipas ankesës se ushtruar nga debitori, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1007/22 dt.14.11.2023, me datë 30.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1007/22 dt.14.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1007/22 dt.14.11.2023, ne pjesën e I te dispozitivit te aktvendimit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.66/21 dt.19.03.2021 te lejuar nga Përmbaruesi Privat Afet Mjeku për pjesën e detyrimit ne shumen prej 891.80 euro. Ne pjesën e II te dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, ndërsa urdhrin përmbarimor P.nr.66/21 dt.19.03.2021 te lejuar nga Përmbaruesi Privat Afet Mjeku, e ka lenë ne fuqi për pjesën e detyrimit prej 10,195.60 euro, ndërsa ne pjesën e III te dispozitivit te aktvendimit e ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbarimore te kreditorit NTG Blendi ndaj debitorit Komuna e Prishtinës sipas urdhrit përmbarimor P.nr.66/21 dt.19.03.2021, për pjesën e detyrimit ne shumen prej 891.80 euro.

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë debitori, për shkak te cenimit thelbësor te dispozitave te procedurës kontestimore dhe përmbarimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e

shkalles se dytë aktvendimin e atakuar ta ndryshoj, ankesën e debitorit ta aprovoj si te bazuar dhe propozimin e kreditorit ta refuzoj.

Përgjigje ndaj ankesës se debitorit ka ushtruar kreditori, me arsyetimin se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit, propozon qe gjykata ta refuzoj ankesën e debitorit , aktvendimi i atakuar te mbetet ne fuqi dhe te obligohet debitori te paguaj shpenzimet e përpilimit te përgjigjes ne ankesë ne shumen prej 208 euro si dhe shpenzimet tjera.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NTG Blendi” me nr. Biznesi 80077076 me seli ne Prishtinë rr.”Gustav Mayer” nr.13, me datën 19.03.2021 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, në bazë të dokumenteve të besueshme - Faturave Nr. 2112-210-001-18, Nr. 2113-210-001-18, Nr. 1215-210-001-18, Nr. 1117-210-001-18, Nr. 2173-210-001-18, Nr. 2114-210-001-18, Nr. 2506-210-001-19, Nr. 663-210-001-19, Nr. 2511-210-001-19, Nr. 698-210-001-19, Nr. 2509-210-001-19, Nr. 62-210-001-19, Nr. 2556-210-001-18, Nr. 286-210-001-18, Nr. 2115-210-001-18, Nr. 2168-210-001-18, Nr. 769-210-001-18, Nr. 2111-210-001-18, Nr. 4175-210-001-18, Nr. 2172-210-001-18, Nr. 620-210-001-18, Nr. 2235-210-001-19, Nr. 2402-210-001-19, Nr. 1682-210-001-18, Nr. 3836-210-001-18, Nr. 2169-210-001-18, Nr. 591-210-001-18, Nr. 1898-210-001-19, Nr. 3837-210-001-18, Nr. 2167-210-001-18, Nr. 1679-210-001-18, Nr. 190-210-001-18, Nr. 1784-210-001-19, Nr. 3840-210-001-18, Nr. 2166-210-001-18, Nr. 1642-210-001-18, Nr. 1169-210-001-19, Nr. 1622-210-001-19, Nr. 3838-210-001-18, Nr. 2165-210-001-18, Nr. 1639-210-001-18, Nr. 3754-210-001-18, Nr. 2164-210-001-18, Nr. 1637-210-001-18, Nr. 3554-210-001-19, Nr. 1543-210-001-19, Nr. 3054-210-001-19, Nr. 1542-210-001-19, Nr. 2780-210-001-19, Nr. 1377-210-001-19, Nr. 3660-210-001-18, Nr. 2162-210-001-18, Nr. 1629-210-001-18, Nr. 3653-210-001-18, Nr. 2163-210-001-185, Nr. 1635-210-001-18, Nr. 2768-210-001-19, Nr. 1372-210-001-19, Nr. 3418-210-001-18, Nr. 2161-210-001-18, Nr. 1636-210-001-18, Nr. 2552-210-001-19, Nr. 1260-210-001-19, Nr. 3405-210-001-18, Nr. 2160-210-001-18, Nr. 1606-210-001-18, Nr. 2521-210-001-19, Nr. 1328-210-001-19, Nr. 3095-210-001-18, Nr. 2159-210-001-18, Nr. 1435-210-001-18, Nr. 2520-210-001-19, Nr. 1081-210-001-19, Nr. 2966-210-001-18, Nr. 2156-210-001-18, Nr. 1218-210-001-18, Nr. 2513-210-001-19, Nr. 815-210-001-19, Nr. 3080-210-001-18, Nr. 2157-210-001-18, Nr. 1427-210-001-18, Nr. 2512-210-001-19, Nr. 356-210-001-19, Nr. 2615-210-001-18, Nr. 2155-210-001-18, Nr. 2154-210-001-18, Nr. 2153-210-001-18, Nr. 2152-210-001-18, Nr. 2140-210-001-18, Nr. 2116-210-001-18, Nr. 2151-210-001-18, Nr. 2119-210-001-18, Nr. 2149-210-001-18, Nr. 2120-210-001-18, Nr. 2123-210-001-18, Nr. 2147-210-001-18, Nr. 2121-210-001-18, Nr. 2122-210-001-18, Nr. 2124-210-001-18, Nr. 2125-210-001-18, Nr. 2127-210-

001-18, Nr. 2126-210-001-18, Nr. 2128-210-001-18, Nr. 2131-210-001-18, Nr. 2132-210-001-18, Nr. 2134-210-001-18, Nr. 2139-210-001-18, Nr. 2133-210-001-18, Nr. 2136-210-001-18, Nr. 2137-210-001-18, Nr. 2148-210-001-18, Nr. 2145-210-001-18, Nr. 2129-210-001-18, Nr. 2130-210-001-18, Nr. 2138-210-001-18, Nr. 2135-210-001-18. Përmbaruesi Privat Afet Mjeku Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me urdhrin përmbarimor P.nr.66/21 dt.19.03.2021, e ka obliguar debitorin që kreditorit, ne afat prej 7 ditësh nga dita e urdhrit përmbarimor ta paguaj shumen prej 11,087.40 euro, me kamatë prej 8% nga dita kur ka qenë i obliguar deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrit përmbarimor debitori me datën 25.03.2021, ka ushtruar prapësim, me te cilin ka deklaruar se dokumentet në bazë të cilave është marrë urdhri përmbarues nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë, pasi te njëjtat nuk janë te nënshkruara ashtu që nuk mund te jenë objekt përmbarimi. Tutje ka shtuar se disa fatura janë të parashkruara ndërsa tjerat mbeten kontestuese për faktin se janë të njëanshme. Në vazhdim ka deklaruar se nuk është përfillur Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF rreth shpenzimit te parasë publike si dhe nuk është zbatuar Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Andaj i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj në tërësi prapësimin si të bazuar, shfuqizoj urdhrin përmbarimor si dhe të obligohet kreditori që t'i mbuloj shpenzimet e procedurës përmbarimore, përfshirë edhe shpërblimin e avokatit për përpilimin e prapësimi.

Kreditori, me datën 06.05.2021 ka parashtruar përgjigje në prapësim, përmes se cilit ka arsyetuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar, se debitori nuk ka paraqitur asnjë dëshmi ne pajtim me LPP -nenin 69 par.4, se debitori ka paraqitur prapësim vetëm për ta zvarritur procedurën, andaj propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin si të pa bazuar, urdhrin përmbarimor ta lë ne fuqi si dhe ta obligoj debitorin që t'i mbuloj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim ne shumen prej 208 euro dhe shpenzimet tjera.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkalles se parë, pas analizimit te prapësimi dhe përgjigjes ne prapësim, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Në vendimin e saj te atakuar gjykata i është referuar nenit 29 dhe 37 te LPP dhe ka gjetur se Urdhri përmbarimor P.nr.66/21 i datës 19.03.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas faturave Nr. 2512-210-001-19, Nr. 2513-210-001-19, Nr. 2520-210-001-19, Nr. 2521-210-001-19, Nr. 2768-210-001-19, Nr. 1542-210-001-19, Nr. 2167-210-001-18, Nr. 2402-210-001-19, Nr. 2509-210-001-19, Nr. 2511-210-001-19, Nr. 2506-210-001-19, për shkak se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së, sepse nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht te njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se janë pranuar nga i njëjti. Po ashtu gjykata referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077) ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar. Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat Nr. 190-210-001-18, Nr. 591-210-001-18, Nr. 620-210-001-18, Nr. 769-210-001-18, Nr. 286-210-001-18 në shumën prej 375.00 €, janë parashkruar sipas nenit 355 të LMD, pasi që propozimi i kreditorit për përmbarim është paraqitur me datë 19.03.2021,

ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit/ arritjes për pagesë, për këtë arsye vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, andaj pjesërisht e aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit për shumën prej 891.80 €. Ndërsa në lidhje me pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor për pjesën tjetër të detyrimit në shumën prej 10,195.60 €, pasi që përkitazi kësaj pjese të detyrimit urdhri përmbartimor është i bazuar dhe nuk ka vjetërsimparashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata dhe se faturat në bazë të cilave është iniciuar propozimi për përmbartim, i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 të LPP-së. Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: “*Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera*”, vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të pjesshëm të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, shkalla e parë drejtë bazuar në provat në lëndë ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike kur ka konstatuar se faturat e lëshuara nga ana e kreditorit Nr. 2512-210-001-19, Nr. 2513-210-001-19, Nr. 2520-210-001-19, Nr. 2521-210-001-19, Nr. 2768-210-001-19, Nr. 1542-210-001-19, Nr. 2167-210-001-18, Nr. 2402-210-001-19, Nr. 2509-210-001-19, Nr. 2511-210-001-19, Nr. 2506-210-001-19, nuk përmbajnë nënshkrimin e debitorit ose edhe vulën e debitorit, elemente këto të parapara me nenin 29 par.3 të LPP, i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, pra në rastin konkret këto fatura, mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi nuk i plotësojnë kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm, të njëjtat nuk e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilit dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbartueshmërisë së titullit ekzekutiv dhe mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimit si i tillë nga debitori ose edhe vulën e pranimit nga organi përkatës i

debitorit. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve e që ne rastin konkret përkitazi kësaj çështje gjykata e shkallës se dytë vlerëson përfundimin juridik të gjykatës se shkallës së parë e kështu edhe nenin 43 par.4 të LPP. Po ashtu edhe kjo gjykate vlerëson se detyrimi nga faturat Nr. 190-210-001-18, Nr. 591-210-001-18, Nr. 620-210-001-18, Nr. 286-210-001-18, është parashkruar e kjo marrë për bazë faktin se propozimi i kreditorit për përmbarim është paraqitur me datë 19.03.2021 ndërsa në raport me secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart rezulton se kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e arritjes për pagesë,. Në lidhje me këtë çështje kjo gjykatë vlerëson nenin 355 par.1 të LMD i cili parasheh që *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite, ndërsa par.2. parasheh që “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer” nga del se edhe për këtë gjykatë ka kaluar afati ligjor i të drejtës për ushtrimin e kërkesës për përmbushje të detyrimit.*

Kjo gjykatë analizon pretendimet e palës debitore se kreditori ka bashkangjitur fatura të cilat nuk plotësojnë kushtet ligjore nga neni 22 lidhur me nenin 29 të LPP sepse faturat janë të panënshkruara nga dy palët, dhe se gjykata e shkallës së parë ka bere cenim thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, por vlerëson se këto pretendime nuk janë të bazuara sepse gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendim të arsyetuar ligjërisht ku me të drejtë ka konstatuar se një pjesë e faturave dhe atë Nr. 2512-210-001-19, Nr. 2513-210-001-19, Nr. 2520-210-001-19, Nr. 2521-210-001-19, Nr. 2768-210-001-19, Nr. 1542-210-001-19, Nr. 2167-210-001-18, Nr. 2402-210-001-19, Nr. 2509-210-001-19, Nr. 2511-210-001-19, Nr. 2506-210-001-19, e mbi bazën e të cilave është lëshuar urdhri përmbarimor nuk plotësojnë kushtet ligjore për ekzekutim, ndërsa pjesa tjetër e faturave, mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi e që kapin shumën e detyrimit prej 10,195.60 euro janë të nënshkruara nga debitori çka konsiderohet se janë pranuar në mënyrë të rregullt nga i njëjti, pra përmbajnë elementet e parapara me nenin 29 par.3 të LPP i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe nenit 37 të LPP sepse këto fatura propozimit për përmbarim i janë bashkëngjitur në kopje por të noterizuara nga noter Zyfer Ali me seli në Lipjan, e me këtë edhe fatura Nr. 769-210-001-18 në vlerën prej 43 euro, të cilën gjykata e shkallës së parë e ka listuar në kuadër të faturave me detyrim të parashkruar, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në lidhje me këtë faturë nuk kemi të bëjmë me parashkrim sepse s’ka kaluar afati i parashkrimit i paraparë me ligj, ndërsa e njëjta është e nënshkruar ashtu që konsiderohet se është pranuar nga debitori prandaj edhe shuma nga kjo faturë mbetet detyrim i debitorit ndaj kreditorit.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i

kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkalles së Dytë

K.Dh.Shk.II.nr.302/24, me datën 30.12.2024,

Gjyqtari,
Dren Rogova,